



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr.1048/2024

Datë: 15 tetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 6 paragrafët 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 15 tetor 2024, mori këtë:

VENDIM

1. Për shpalljen e konkursit për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
2. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë pune nga data 21 tetor 2024 deri me datë 08 nëntor 2024, si dhe duhet t'i përmbajë informatat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe Shpalljen e konkursit t'i publikojë në faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe fizikisht në të gjitha ndërtesat e prokurorive.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.